



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.854/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Dard” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.E., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, KF.nr.359/22 të datës 18.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.27.06.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë- Departamenti Fiskal, KF.nr.359/22 të datës 18.05.2023, **Vërtetohet**.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, “Dard” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.E. nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi&Lata”-Prishtinë. Në pikën II. të dispozitivit e ka anuluar vendimin e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë nr.300/2019 i datës 27.08.2019. Në pikën III. ka obliguar të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë që paditësit “Dard” ShPK me seli në Prishtinë, t’ia kthej mjetet e paguara në emër të gjobës administrative në shumë prej 5,000.00€ (pesëmijë euro), sipas vendimit 300/2019 të datës 27.08.2019, me kamatë ligjore në shkallë të përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga paditësi 05.10.2015 dhe datës kur e paditura e referon për pagesë-rimburësim Ministrisë së Financave në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar e paditura, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material si dhe shkeljeve procedurale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të nxjerrë aktgjykim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e Administratës Tatimore të Kosovës, të anulohet aktgjykimi KF.nr.359/22 i datës 18.05.2023 i Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, të mbetet në fuqi vendimi nr.300/2019 i datës 27.08.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës. Ose të nxjerrë aktvendim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, të priset aktgjykimi KF.nr.359/22 i datës 18.05.2023 i Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal dhe lënda i kthehet gjykatës ë shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesë duke konsideruar se pretendimet e paditurës në ankesë janë tërësisht të pa bazuara dhe të paqëndrueshme. Andaj ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë- Departament Fiskal KF.nr.359/2022 i datës 18.05.2023 të vërtetohet.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H,të Ligjit,nr.04/L-102, për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ATK-në dhe procedurat, nr.03/L-222, dhe nenit 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), gjen se;

- Ankesa është e **pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.300/2019 i datës 27.08.2019, nën pikën I. të dispozitivit, është refuzuar si e pa bazë ankesa në ri procedurë me nr.300/2019 e datës 03.07.2019, e subjektit “Dard” ShPK me adresë “Kroi i Bardhë” Prishtinë, (NRB) 70990342, (NRF): 601015375 me pronar z. D.J.-Zyra Regjionale Prishtina2, sipas Aktgjykimit A.nr.661/16 të datës 06.06.2019 të Gjykatës Themelore në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr.03/L-222, “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”. Nën pikën II. Refuzimi i Dokumentit të Vendosijes së Ndëshkimit nr.MFA2R0000072777K të datës 02.06.2015 në vlerë prej 5,000.00€ të lëshuar nga Administrata Tatimore-Njësia e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës (NJHTI), vërtetohet si i bazuar.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.300/2019 i datës 27.08.2019 të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë

e paditësit e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e anulon vendimin e lartcekur të Administratës Tatimore të Kosovës. Me arsyetim se Gjykata ka gjetur se e paditura në arsyetim të aktvendimit kontestues nr. 300/2019, ka theksuar se gjoba prej pesëmijë (5,000.00) Euro është vendosur komfor nenit 58 paragrafi i 4 i Ligjit Nr.03/L-222, për keqpërdorim të certifikatës të TVSH-së, që në këtë rast sipas të paditurës, subjekti “Dard” ShPK ia ka dhënë në shfrytëzim certifikatën e TVSH-së z.F.Xh. për importimin e mallrave, por që e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se cilat mallra dhe me cilat deklarata unike doganore janë importuar nga F.Xh. duke e përdorur certifikatën e TVSH-së së këtu paditësit, për të mundur të aplikohen dispozitat ndëshkuese si më lartë. Tutje e paditura është mjaftuar vetëm me konstatimin se inspektori hetues nuk ka mundur të kontaktoj pronarin e biznesit z. D.J., për të konfirmuar përdorimin eventual të certifikatës së TVSH-së së këtu paditësit të gjetur tek z. F.Xh, dhe për të mundur të vërtetohet se cili është roli i këtij të fundit në raport me këtu paditësin, andaj vetëm për këtë pa mundësi të kontaktimit të inspektorit hetues të ATK-së në ditën kritike me subjektin këtu paditësin për të mundur të ndriçohet rrethanat si më lartë, i njëjti ka iniciuar procedurën pranë ATK-së, me q ‘rast këtu paditësi e me datën 27.01.2016 përmes personin kontaktues z. F.Xh. pranoi në ATK dokumentin e ndëshkimit të lëshuar sipas dispozitave ligjore të nenit 58, paragrafi 4 i Ligjit NR.03/L-222. Konstatimi i të paditurës dhënë në arsyetim të vendimit kontestues se paditësi me rastin e dhënies në përdorim të certifikatës së TVSH-së z. F.Xh. ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 58 paragrafi 4 i Ligjit NR.03/L-222, nuk qëndron për faktin se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga elementet ligjore nga dispozita si më lartë, ngase malli i deklaruar me deklaratën unike doganore nr. 4082/27.04.2015, është i zhdoganuar në emër të subjektit “Dard” ShPK. me seli në Prishtinë, i njëjti mall është deklaruar nga Agjenti doganor A... sipas autorizimit përkatës. Tutje dispozitat li më lartë në asnjë nga geramat e tyre nuk parashohin mundësinë e shqiptimit të ndëshkimit si në rastet e konstatuara nga Shënimi për aktivitet të inspektorit i datës 02.06.2015 e ku është shënuar se: *në pamundësi të komunikimit me personin e biznesit të lartcekur – drejtorin e biznesit dhe pas vlerësimi tatimor lëshoj gjobë ndëshkim administrativ lidhur me TVSH.* Për më tepër edhe vet e paditura në shënimin për aktivitet të inspektorit të datës 27.01.2016, i referohet F.Xh. si përfaqësues i biznesit “Dard” ShPK. E paditura as me përgjigje në padi dhe as në seancë gjyqësore nuk e ka arritur të prezantoj deklaratën e datës 16.10.2015 për të vërtetuar pretendimet e veta. Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43, par 3 dhe 46 par. 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e obligoj të paditurën që paditësit t’ia kthej mjetet e paguara pa bazë nga pagesa e ndëshkimit/gjobës administrative në shumë prej 5,000.00 euro, (pesëmijë) Euro, sipas vendimit nr.MFA2R0000072777K të datës 02.06.2015 dhe e paguar me fletëpagesën bankare të datës 05.10.2018. Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi të datës 18.04.2023, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Kjo për faktin se paditësi pretendimet e veta siç u vlerësuar edhe më lartë i ka të bazuara në dokumentet të besueshme lidhur me përdorimin e certifikatës e TVSH-së, e të cilat janë administruar si prova nga gjykata dhe të cilat nuk ka mundur ti kundërshtoj as e paditura me ndonjë provë materiale. Gjykata nga fletëpagesa bankare e datës 05.10.2015, vërtetoi pagesën e gjobës sipas vendimit nr.MFA2R0000072777K të datës 02.06.2015. Në lidhje me kamatën gjykata ka vendosur si në

dispozitiv të aktgjykimit në pajtim me dispozitën e nenit 57.4 të Ligjit nr.2044/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të Dhomës së Shkallës së Parë sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për konflikte administrative të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 41 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar vendimin e organit të paditur. Andaj nuk janë të qëndrueshme pretendimet në ankesë se gjykata ka shkel dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore për faktin se në vendimin e ankimuar thekson respektimin e kësaj dispozite ligjore por në fakt nuk i elaboron të gjitha provat e paraqitura e për më tepër kundërshtimet e paraqitura në përgjigje në padi duke mos pasur kujdes në çmuarjen me ndërgjegje të kësaj prove të prezantuar në këtë proces gjyqësor, pasi që procedura në tërësi është zhvilluar në baza ligjore, janë administruar prova të mjaftueshme të palëve ndërgjygjëse të shtjelluara në tërësi si në arsyetim të aktgjykimit lidhur me mënyrë e vendosjes së çështjes, nga rezulton se Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur .

Pretendimet ankimore të se vendimi ankimuar dështon në konstatimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata në vendimi e saj është mjaftuar vetëm me konstatimin se inspektori hetues nuk ka mundur të kontaktoj pronarin e subjektit “Dard” ShPK- paditësin, po ashtu gjykata nuk ka marr parasysh faktin se konstatimi i gjendjes faktike nga ana e ATK dhe Doganës është bërë në momentin e vizitës në të cilin nuk kanë qenë prezent pronari dhe ky konstatim i gjendjes faktike bëhet në momentin e caktuar kohor. Kolegji i shqyrtoi me kujdes dhe të njëjtat i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara dhe gjen se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankesë, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor, dhe në bazë të provave të administruara në seancën kryesore, si dhe shkresave të tjera ka nxjerrë prova të mjaftueshme, në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendja faktike, me aprovimin e kërkesë padisë si në vështrim të nenit 43, par.3 dhe 46 par.3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar

edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.854/23, me datë 16.04.2024**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**